



## Kalendari i aktiviteteve për Javën e Parasë

25-31 mars 2019

Javë e Parasë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si shumë institucione të tjera në mbarë globin organizojnë aktivitete të larmishme për t'i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, duke u mësuar si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht apo si t'i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre nëpërmjet kulturës financiare.

### Organizatorë:

Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), ANFE.

**Tema e këtij viti është: “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër!”**

**E hënë, 25 mars 2019**

**Ora 11:00, Tiranë**

Ceremonia e çeljes së Javës së Parasë organizohet në ambientet e Muzeut të Bankës së Shqipërisë. Zëvendësgovernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, Zëvendësministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave në fjalët e tyre të shkurtra përshëndetëse theksojnë ndër të tjera misionin e Javës së Parasë dhe promovojnë rëndësinë e kulturës financiare për publikun e gjerë dhe në veçanti për brezat e rinj.

Pas fjalëve të rastit, aktiviteti vijon me shpërndarjen e çmimeve për fituesit e 4 konkurseve të lançuara një muaj më parë nga BSH dhe AAB. Zëvendësgovernatorja Minxhozi, Kryetari i AAB Pedrazzi, Zëvendësministrja Haxhiu, së bashku me drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare që sponsorizojnë çmimet për fituesit e konkurseve, ndajnë çmimet dhe bëjnë foto me nxënësit dhe studentët fitues.

- 1. Konkursi për nxënësit e klasave VI të shkollës 9-vjeçare me projekte “Mëso. Kurse. Fito!”**
- 2. Konkursi për nxënësit e klasave të IX me fotomontazhe “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër: një 0 më shumë bën diferencën”**
- 3. Konkursi për nxënësit e shkollave të mesme “Videoja më e mirë” me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër!”**



**E martë, 26 mars 2019**

**Ora 10:00**

**Programi i “Edukimit të Punëkërkuesve të Rinj në sektorin bankar”**

Partnerët Shqipëri do të shpallë hapjen e programit trajnues për punëkërkuesit e rinj për vitin akademik 2019-2020, duke organizuar sesione informimi në universitete publike dhe jopublike.

**Ora 10:00, Tiranë**

**Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe prezantim me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”**

Nxënës të shkollës “Vatra e Dijes” do të vizitojnë Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në muze, nxënësit mund të ndjekin një prezantim me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”.

**Ora 10:30, Tiranë**

**Leksion i hapur në Universitetin e Tiranës** nga: Erald Themeli, Drejtor i Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë, me temë “Roli i Bankës së Shqipërisë në stabilitetin ekonomik të vendit”.

**Ora 12:00, Tiranë**

**Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe prezantim me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”**

Nxënës të shkollës së mesme Hoteleri Turizëm do të vizitojnë Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në muze, nxënësit mund të ndjekin një prezantim me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”.

**E mërkurë, 27 mars 2019**

**Ora 10:30, Korçë**

**Leksion i hapur në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë** nga: 1. Eris Sharxhi, Përgjegjës i Sektorit të Mbikëqyrjes së Rreziqeve, në Departamentin e Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë, me temë “Historiku dhe zhvillimet kryesore në sistemin bankar shqiptar”; 2. Andi Habilaj, Përgjegjës i Zyrës së Mbikëqyrjes së Rreziqeve të Tregut dhe të Likuiditetit, në Departamentin e Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë, me temë “Administrimi i bankave dhe funksioni mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë”.



**Ora 11:00, Tiranë**

**Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe orë mësimore me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”**

Nxënës të klasave IV-VIII të shkollës “Udha e Shkronjave” do të vizitojnë Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në muze, fëmijët mund të ndjekin një prezantim me temë **“Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”**.

**Ora 11:00, Tiranë, Durrës, Elbasan**

**“International trade Game”**

Junior Achievement do të organizojë tre kampe njëditore rajonale, në Elbasan, Tiranë dhe Durrës. Do të jenë 90 shkolla të përfaqësuara, rreth 100 nxënës në total. International trade Game është një format edukativ, ku nxënësit në grupe vihen në pozicionin e shteteve dhe operojnë në tregjet ndërkombëtare.

**E enjte, 28 mars 2019**

**Ora 10:00, Tiranë**

**Vizitë në Muzeun e BSH-së**

Fëmijë të kopshtit “Yjet e së ardhmes” do të vizitojnë Muzeun e Bankës së Shqipërisë.

**Ora 11:00, Tiranë**

**Kuizi Evropian i Parasë (European Money Quiz)**, i cili zhvillohet për herë të dytë në vitin 2019, si një konkurs mbarevropian me qëllim përmirësimin e kulturës financiare të fëmijëve të moshës 13 - 15 vjeç. Klasat e 9-ta do të konkurrojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën gjatë një aktiviteti *“live”*, në platformën Kahoot! ora 11:00, në Tiranë, në qendrën kulturore Ortodokse. Klasa më e zgjuar dhe më e shpejtë, do të duhet t’i përgjigjet saktë dhe shpejt 10 pyetjeve të konkursit kombëtar. Çdo klasë do të mund të përfaqësohet me nga 2 skuadra me 2 nxënës. Në fazën e dytë, dy studentët fitues kombëtarë, të shoqëruar nga mësuesja kujdestare, do të ftohen të luajnë në finalen evropiane të Kuizit Evropian të Parasë, të mërkurën më 7 maj në Bruksel. Çmimi i madh prej 3000 eurosh i shpërndahet klasës së fituesve.

**Ora 12:00, Tiranë**

**Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe prezantim me temë “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”**

Nxënës të shkollës së mesme Hoteleri Turizëm do të vizitojnë Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në muze, nxënësit mund të ndjekin një prezantim me temë **“Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”**.



**E premte, 29 mars 2019**

**Ora 11:00, Durrës**

**Leksion i hapur në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, nga z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, me temë "Roli i bankës qendrore në zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit - Stabiliteti financiar, një parakusht i domosdoshëm në zhvillimin ekonomik".**

**Ora 11:00, Shkodër**

**Leksion i hapur në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodrës, nga: 1. Juna Bozdo, Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit Sistemik, të Departamentit të Stabilitetit Financiar në Bankën e Shqipërisë, me temë "Stabiliteti financiar, roli i Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e tij dhe paketa e deeuroizimit". 2. Ekspert nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, me temë "Skema e sigurimit të depozitave për bankat dhe SHKK-të në vendin tonë. Roli dhe funksionet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave".**

**Ora 11:00, Tiranë**

***Innovative Talk "Nga një aplikacion për Financat personale tek Biznesi" – nga Perjan Duro***

Perjan Duro, ish punonjës i Raiffeisen Bank, aktualisht punon dhe jeton në Gjermani, është krijuesi i MoneyCoach. Ai do të mbajë një prezantim për aplikacionin e krijuar prej tij me qëllim promovimin e ideve novatore në funksion të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare.